

Takimi i njëzetekatërt i Bordit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC)

Sarajevë, 15 tetor 2014



Në takimin e Bordit të RCC-së, Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së Goran Svilanovic, prezantoi aktivitetet e Sekretariatit të RCC-së për periudhën prill- shtator 2014 dhe informoi për aktivitetet e ardhshme, sidomos ato të lidhura me implementimin e strategjisë së RCC dhe Programit të Punës për 2014-2016 mbështetur në shtyllën qëndrore, Strategjinë e Europës Juglindore 2020, (SEE 2020).

Z. Svilanović theksoi se sinergjia midis RCC dhe Kryesisë Shqiptare të SEECP-së ka një rol të pa zëvendësueshëm në koordinimin e veprimtarive në Evropën Juglindore, duke u shprehur se: “kemi eksploruar fushat ku veprimi i përbashkët mund të ndërmerret dhe në cilat mënyra RCC-ja mund të mbështesi efektivisht kryesinë e SEECP-së”.

Përfaqësuesi i Kryesisë të SEECP-së konfirmoi se: kryesia Shqiptare është e vendosur të promovojë fqinjësinë e mirë dhe bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore. Ai evidentoi moton e kryesisë shqiptare të SEECP-së, “Regional Ownership in Action” dhe theksoi se kryesia po realizohet në kontekstin e zhvillimeve të rëndësishme në Ballkanin Perëndimor, duke ju referuar procesit që inicioi Konferenca e Berlinit, në 28 gusht 2014 si një shtysë politike për rrugën e anëtarimit në BE të rajonit, si dhe bashkëpunimin e zgjeruar me Proçesin e Stabilizim Asocimit.

Ai vuri në dukje se kalendari i aktiviteteve të kryesisë ndër të tjera përfshin Samitin e Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të vendeve të SEECP-së, takimi midis ministrave të jashtëm të SEECP-së ministeriale sektorial (Bujqësi, Energji, Drejtësi dhe Punët e Brendshme), takime të drejtoreshave politike, takimi i Asamblesë Parlamentare të SEECP-

së dhe takime të Grupit të Punës Ad-hoc mbi të ardhmen e SEECP-së. Më tej ai njoftoi se takimi i parë i Drejtoreve Politik të SEECP-së është planifikuar për 5-6 nëntor, së bashku me takimin e grupit Ad-hoc të punës. Ai vuri në dukje se gjatë kryesisë sonë të SEECP-së, procedurat për zgjedhjen ose rizgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të RCC do të përfundojnë. Përfaqësuesi i Kryesisë shqiptare të SEECP-së evidentoi rëndësinë e sigurimit të vazhdimësisë së punës dhe në këtë kontekst, informoi se kryesia Shqiptare do të organizoi, takimin e Instituteve të Statistikave të Rajonit më 23 tetor në Tiranë, si dhe konferencën e nivelit të lartë për Antikorrupsionin në 13-14 nëntor po në Tiranë.